



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë/a:	13.04.2021
Referenc-ë:	07-353/01-62657/21
Për/ Za/ To:	"Voice of Roma, Ashkali and Egyptians"
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën tuaj me nr protokollit 07-353/01-62657/21 nga "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians" me përfaqësues Isak Skenderi - Drejtor Ekzekutive me të cilën kërkohet që me datë 15 Prill 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike, Sheshi "Zahir Pajaziti" nga ora 10:00 deri në 15:00. Qëllimi i aktivitetit është organizimi i Ekspozitës ku përmes 50 fotografive do të prezantohet puna 10 vjeçare e organizatës "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians".

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin "Zahir Pajazit" me datën 15 Prill 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.

14/04/2021

Handwritten signature